




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kujtesa Nezaj-Shehu
Florentina Grubi-Vula
Përfaqësuese të Shell Brands International AG Baarermatter, CH-6340 Baar, Zvicër
Prishtinë

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

09-02-2021

Ref. 2102/082/KPM/xh

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2020/94 – Shell Brands International AG Baarermatter, CH-6340 Baar, Zvicër (Palë ankuese) kundër Radio Kosova 1 dhe Glam Radio

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 22 dhjetor 2017 ka miratuar Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07 me të cilën janë përcaktuar parimet themelore të komunikimeve komerciale audiovizuale gjatë emetimit të tyre nga ofruesit e shërbimeve mediale, duke përfshirë përmbajtjen, çështjet etike dhe kohëzgjatjen e komunikimeve komerciale audiovizuale.
2. KPM me datën 6 nëntor 2020 ka pranuar Ankesë të parashtruar nga Pala ankuese, përfaqësuar nga Kujtesa Nezaj-Shehu dhe Florentina Grubi-Vula, avokate në Prishtinë, kundër Radio Kosova 1 dhe Glam Radio, me pretendimin se transmetojnë një komunikim komercial të HIB Petrol, në të cilën *“iu komunikohet konsumatorëve se kinse HIB Petrol furnizohet nga Coral Shell... si dhe reklamat çorientuese në radiostacionet lokale nuk bazohen në ndonjë marrëveshje, dhe se veprimet e tilla janë keqdrejtuese dhe prandaj jo ligjore. Reklamimi i produkteve në baza ditore në radio lokale duke ju referuar produkteve të Palës ankuese janë të ndaluara dhe duhet të trajtohen si komunikime komerciale të pavërteta lidhur me origjinën e mallrave, bazuar në nenin 6, paragrafin 5, nënparagrafin 5.1 të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale nr. 2017/07”, duke shtuar se “kjo reklamë duhet të ndalohet së transmetuari.”*
3. KPM, me datën 9 nëntor 2020, iu ka dërguar shkresë Radio Kosova 1 dhe Glam Radio, me të cilat i ka njoftuar për Ankesën e pranuar dhe ka kërkuar sqarim lidhur për Ankesën në fjalë.
4. KPM ka pranuar shkresë nga radiot e lartpërmendura, ku e kanë bashkangjitur edhe Përgjigjen e përfaqësuesve të HIB Petrol, të cilët janë deklaruar për dy rastet në fjalë, duke theksuar se: *“HIB Petrol në rastin konkret ka vepruar në përputhje me të gjitha ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. E njëjta i respekton të drejtat ligjore dhe autorizimet e të gjitha bizneseve dhe konkurrentëve në treg si dhe nuk është në shkelje të asnjë marke tregtare të mbrojtur me ligj, duke përfshirë atë të Palës ankuese.*

Rrjedhimisht, HIB Petrol është plotësisht e vetëdijshme se ka për detyrim ligjor informimin e plotë të konsumatorëve mbi origjinën e mallit (produkteve të lëngëta të naftës) të cilën e furnizon, cilësinë dhe karakteristikat tjera të mallit.” Ky informim i plotë i konsumatorëve nga ana e HIB Petrol lidhur me naftën që ofertohet, është në përputhje të plotë me parimin e përdorimit të ndershëm të markave tregtare me qëllim të informimit të konsumatorëve. Kjo është në harmoni edhe me kornizën ligjore të aplikueshme, e që është Ligji për Markat Tregtare në fuqi.” Në fund të sqarimit, theksohet se: “Përfundimisht, HIB Petrol është e licencuar pranë Zyrës së Licencimit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë si dhe HIB Petrol është blerës i derivateve të Shell License Product, derivate këto që importohen në Kosovë në mënyrë ligjore dhe për të cilat e njëjta është e pajisur me Dokument Unik Doganor (DUD).”

5. KPM, në bazë të Raporteve të monitorimit për dy radiot e lartpërmendura, të datës 23 nëntor 2020, ka gjetur se të dyja palët kanë pretenduar dhe kanë ofruar sqarime për të drejtën e tyre rreth çështjes së ngritur në Ankesën e parashtruar.
6. KPM, me datën 24 nëntor 2020, me qëllim të vlerësimit të pretendimeve ankimore iu ka dërguar shkresa përfaqësueseve të Palës ankuese, Radio Kosova 1 dhe Glam Radio, duke iu kërkuar të ofrojnë dëshmi nga organet kompetente mbi të drejtën e përdorimit të markës së Palës ankuese.
8. KPM, me datën 26 nëntor 2020, nga përfaqësueset e Palës ankuese ka pranuar dëshmi mbi të drejtën e përdorimit të markës së Palës ankuese në Kosovë, të lëshuar nga Zyra e Pronësisë Industriale e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në të cilën shkruhet se data e skadimit të mbrojtjes përfundon më 25.06.2015.
9. KPM, me datën 4 dhjetor 2020, ka mbajtur takim me përfaqësuesit e HIB Petrol, me të cilët është diskutuar rreth çështjeve të ngritura në Ankesë. Nga ta është kërkuar që të ofrojnë dëshmi sipas shkresës së KPM-së të dërguar me 24 nëntor 2020.
10. KPM, me datën 18 dhjetor 2020, nga përfaqësuesit e HIB Petrol ka pranuar dëshmi të importit (6 DUD, dy për secilin muaj: tetor, nëntor dhe dhjetor 2020), me anë të të cilave vërtetohet se importi i derivateve nga HIB Petrol ka origjinën nga Greqia (Shell License Product), siç përmendet në reklamë.
11. KPM në bazë të Raporteve të monitorimit, të datës 21 dhjetor 2020, ka gjetur se Pala ankuese ka ofruar dëshmi me afat të skaduar rreth të drejtës së përdorimit të markës së Palës ankuese në Kosovë, ndërsa përfaqësuesit e HIB Petrol-it kanë ofruar dëshmi rreth origjinës së produktit të reklamuar.
12. KPM, me datën 22 dhjetor 2020, me anë të një shkrese i ka njoftuar përfaqësueset e Palës ankuese për dëshmitë e pranura nga të dy palët dhe se Radio Kosova 1 dhe Glam Radio kanë dëshmuar se reklama të cilën janë duke e transmetuar është e mbështetur në fakte dhe informata të sakta, duke vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

13. KPM, me datën 5 janar 2021, ka pranuar dokumentin e radhës nga përfaqësueset e Palës ankuese, me të cilën dëshmohet vazhdimi i vlefshmërisë së markës të Palës ankuese deri me 25 qershor 2026.

Analiza ligjore

14. Komisioni pretendimet ankimore të Palës ankuese i ka trajtuar në kuptim të nenin 6, paragrafi 5.1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Neni 6, paragrafi 5.1, i Rregullores KPM-2017/07, përcakton se:

“Komunikimet komerciale duhet të jenë të qarta dhe të shmangin faktet shtrembëruese që mashtrojnë publikun me anë të deklaratave apo pohimeve të pavërteta për sa i përket:

5.1. Karakteristikave të mallrave, dobisë së tyre, materialeve, përbërësve dhe origjinës;...”


15. KPM, në bazë të analizimit të të gjitha shkresave të pranura nga të dy palët, ka gjetur se informacioni i dhënë në komunikimin komercial të cilin janë duke e transmetuar Radio Kosova 1 dhe Glam Radio është i mbështetur në fakte dhe informata të sakta dhe se përfaqësuesit e HIB Petrol-it kanë vërtetuar se importi i derivateve e ka origjinën nga Greqia (Shell License Product), siç përmendet në reklamë.
16. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, gjen se Radio Kosova 1 dhe Glam Radio janë në pajtueshmëri me nenin 6, paragrafi 5.1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.


Vendim

17. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës ankuese, përmes së cilës pretendohet se Radio Kosova 1 dhe Glam Radio kanë vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 5.1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

E drejta për ankesë

18. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
19. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



28.01.2021
Datë